




Drejtoria e Arsimit
Nr.07-Zyrtarisht
27.07.2021

Në bazë të nenit 64, paragrafi 1 të Ligjit për Zyrtarët Publik Nr. 06/L-114, nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës, nr. 03/L-212, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.90/2010), Neni 5 pikës c. të Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, nr. 03/L-068, Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit Publik, Udhëzimi Administrativ MASHT Nr. 05/2015 Normativi Për Mësimdhënësit e Arsimit Profesional, Udhëzimit Administrativ MASHT Nr. 10/2018 datë: 20.07.2018 Për Normativin Mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 34/2014 Funksionimi i shërbimit pedagogjik – psikologjik në shkollë, Drejtoria Komunale e Arsimit në Deçan, shpallë këtë:

KONKURS

Për plotësimin e vendeve të punës për vitin shkollor 2021/22

Nr.	Niveli, Shkolla	Pozita	Vend i Lirë /Me kohë të caktuar / Zëvendësim	Numri i pozitive
1	Shkolla Mesme Teknike "Tafil Kasumaj" në Deçan	Mësimdhënës i/e Lëndëve të Mjekësisë (10 orë) - Rishpallje	Vend i Lirë	1
2	Shkolla Filllore Mesme e Ulët "Lan Selimi" në Lumbardh (6 orë); Shkolla Filllore Mesme e Ulët "Kuvendi i Verrave të Llukës" në Llukë e Epërme (4 orë)	Mësimdhënës i/e Teknologjisë Informative (10 orë) - Rishpallje	Vend i Lirë	1
3	Shkolla Filllore Mesme e Ulët "Jusuf Gërvalla" në Prapaqan	Mësimdhënës i/e Gjeografisë (14 orë) - Rishpallje	Kohë të Caktuar (mandati i drejtorit të shkollës)	1
4	Shkolla Filllore Mesme e Ulët "Rexhep Kadrijaj" në Rastavicë (6 orë); Shkolla Filllore Mesme e Ulët "Heronjtë e Dukagjinit" në Gillogjan (4 orë)	Mësimdhënës i/e Gjuhës Gjermane (10 orë) - Rishpallje	Vend i Lirë	1
5	Shkolla Filllore Mesme e Ulët "Sylë Alaj" në Drenoc	Mësimdhënës i/e Matematikës (10 orë) - Rishpallje	Kohë të Caktuar deri më datë 31.03.2022	1
6	Drejtoria e Arsimit, në shkollat e komunës së Deçanit	Psikolog i/e shkolle - Rishpallje	Vend i Lirë	1
7	Drejtoria e Arsimit, në shkollat e komunës së Deçanit	Pedagog i/e shkolle - Rishpallje	Vend i Lirë	1
8	Shkolla Filllore Mesme e Ulët "Esad Mekuli" në Maznik	Roje Natën	Vend i Lirë	1



I. Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:

- Formulari i aplikimit;
- Rezymeja personale (CV);
- Dokumenti personal (letërnjoftimi ose pasaporta - kopje);
- Diploma e kualifikimit e noterizuar;
- Trajnime (nëse ka);
- Vërtetimin për përvojën e punës (nëse ka);
- Certifikata që nuk jeni nën hetim;
- Certifikata e lindjes;
- Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të kenë diplomat e nostrifikuara në MASHT.

II. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor:

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar, ashtu siç planifikohet me UA të MASHT-it për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm nr. 10/2018 të datës: 20.07.2018, Udhëzimi Administrativ MASHT Nr. 05/2015 Normativi Për Mësimdhënësit e Arsimit Profesional dhe Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 34/2014 Funksionimi i shërbimit pedagogjik – psikologjik në shkolla.

Kriteret e kualifikimit për Mësimdhënës Gjuhë Gjermane:

1. Niveli master arsimor – Fakultetit i Edukimit (300 ECTS);
2. Sistemi katërvjeçar;
3. Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS).

Kriteret e kualifikimit për Mësimdhënës Matematikë:

1. Niveli master arsimor – Fakultetit i Edukimit (300 ECTS);
2. Sistemi katërvjeçar;
3. Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS).

Kriteret e kualifikimit për Mësimdhënës Gjeografi:

1. Niveli master arsimor – Fakultetit i Edukimit (300 ECTS);
2. Sistemi katërvjeçar;
3. Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS).

Kriteret e kualifikimit për Mësimdhënës Teknologji Informative:

1. Niveli master arsimor – Fakultetit i Edukimit (300 ECTS);
2. Sistemi katërvjeçar;
3. Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS).

Kriteret e kualifikimit për Mësimdhënës i/e Lëndëve të Mjekësisë:

1. Mjek i përgjithshëm.

Kriteret e kualifikimit për Psikolog i/e shkolle:

Psikolog i shkollës – personi i cili ka përfunduar studimet e nivelit Master në degën e Psikologjisë – drejtimi: Psikologji Shkollore dhe Këshillim, të Fakultetit Filozofik (apo siç është rregulluar më UA 2014 për licencimin e mësimdhënësve dhe bashkëpunësve profesional).

Kriteret e kualifikimit për Pedagog i/e shkolle:

Psikolog i shkollës – personi i cili ka përfunduar studimet e nivelit Master në degën e Pedagogjisë të Fakultetit Filozofik përkatësisht Fakultetin e Edukimit, studimet katërvjeçare në Degën e Pedagogjisë, (apo siç është rregulluar më UA 2014 për licencimin e mësimdhënësve dhe bashkëpunësve profesional).

Kriteret e kualifikimit për Roje Natën: Shkollimi bazik

III. Ligji për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-37 datë 29 gusht 2011, në nenin 16 paragrafi 5 thotë: "Vetëm bartësit (publik) të arsimit të lartë mund të ofrojnë programe studimi që qojnë në kualifikimin e një mësimdhënësi, për tu punësuar në një shkollë".

IV. Vetëm në mungesë të kandidatëve nga sqarimi i lartcekur do të shqyrtohen edhe aplikacionet e kandidatëve me kualifikim më të përafërt.

V. Mosplotësimi i saktë dhe i qartë i formularit të aplikimit, aplikacionet e pakompletuar dhe ato që dorëzohen pas afatit të konkursit nuk do të merren në shqyrtim, përkatësisht refuzohen.

VI. Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente(jo ata që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi).

VII. Për intervistë do të ftohën vetëm kandidatët, të cilët i plotësojnë kushtet sipas akteve ligjore të cekura.

VIII. Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje, (kualifikimet universitare duhet të jenë të noterizuara), dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistës.

Formularin i Aplikimit për Punësime shkarko këtu:

<https://kk.rks-gov.net/decan/wp-content/uploads/sites/9/2021/01/Formulari-Aplikimi-Per-Punesim-07AR.pdf>

Afati dhe mënyra e aplikimit:

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes së konkursit në faqen zyrtare të komunës, duke filluar nga data e publikimit më: 27.07.2021 më datën: 10.08.2021.

Aplikacioni i kompletuar (me të gjitha dokumentet e kërkuara) duhet të dorëzohet përmes zyrës së DKA-së Nr. 52 , në objektin e Komunës së Deçanit.

Drejtori

Ma. sc. Bekim Vishaj

